Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Stalnog Sekretar/Office of the Permanent Secretary

**Nr. 191 / 02-1**
**Dt: 17.08.2011**

Në bazë të nenit 93 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 4 pika 3 të Rregullores së Punës së Qeveris së Kosovës nr. 01/2007, nenit 41 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ nr: 03/2003, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ( MASHT) nxjerr këtë:

## V E N D I M

**Licencohet** Institucioni Arsimor Privat (IAP) "Loyola" në Prizren.
Institucioni Arsimor Privat "Loyola" në Prizren do të ushtrojë veprimtarinë e vet edukative-arsimore në nivelin e mesëm të ulët (2) dhe të mesëm të lartë (3) për vitin shkollor 2011\12 në drejtimin:

- **Gjimnaz i Përgjithshëm**

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

1. Komisioni për licencimin e IAP për nivelet arsimore 1, 2 dhe 3 sipas ISCED i ka udhëhequr të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe profesionale me qëllim të vlerësimit të kërkesës për licencim të Institucionit Arsimor Privat "Loyola" në Prizren, ka konstatuar se ky institucion i plotëson kushtet e dhe kriteret e përcaktuara ligjore për licencimin e drejtimeve të përfshira në pikën 1 të këtij vendimi për arsye se ai:

*a) ka ofruar këto kushte dhe kritere:*

- ka kërkesën me dokumentacionin e kompletuar,
- ka infrastrukturë shkollore të mjaftueshme dhe të përshtatshme me standarde të larta,
- ka laboratorë për lëmin përkatëse,
- ka kuadër mësimdhënës të kualifikuar,
- ka plan programe të pranuara nga MASHT,
- ka plan të specifikuar të biznesit,
- ka aktet e nevojshme nënligjore dhe

b) sipas vlerësimeve të komisionit të MASHT-it, ka ofruar shërbime-programe të avancuara për këtë nivel të shkollimit.

**Udhëzime juridike**: kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në komisionin për ankesa në MASHT.

**Vendimi u dorëzohet:**

- Institucionit të Arsimit Privat
- Kabinetit të Ministrit / MASHT
- Zyrës së SP / MASHT
- Zyrës Inspektimit / MASHT
- Zyrës së Arsimit Privat / MASHT
- Arkivit

**Xhavit Dakaj**
**Sekretar i Përgjithshëm**

UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

| MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË | MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY | MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU |
|---|---|---|
| Zyra e Sekretarit të Përhershëm | Office of the Permanent Sekretara | Kancelarija Stalnog Sekretara |

Nr. 710 / 02-1
Dt: 20.06.2007
Prishtinë

Në bazë të nenit 5.4 pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ) dhe nenit 41 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, si dhe Udhëzimit Administrativ nr: 03/2003, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ( MASHT) nxjerr këtë :

## V E N D I M

1. **Për licencim** Institucionit Arsimor Privat (IAP) "**Loyola - Gymnasium**" në Prizren për ushtrimin e veprimtarisë edukativo–arsimore ,
   Ka qenë i licencuar nga MASHT-të për 1 vit shkollor 2005 /2006, ka treguar sukses ne procesin edukativo-arsimore.
2. **"Loyola – Gymnasium** në Prizren licencohet për 5 (pesë) vite shkollore 2006 / 07 deri 2010 / 11.

IAP "Loyola - Gymnasium " në Prizren do të ushtrojë veprimtarinë e vet arsimore në nivelin e mesëm të ulëte dhe të mesëm lartë (2 dhe 3, sipas ISCED).

Vendimi hynë në fuqi datën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Komisioni për licencimin e IAP për nivelet arsimore 1,2 dhe 3 sipas ISCED i ka udhëhequr të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe profesionale me qëllim të vlerësimit të kërkesës për ri licencim të IAP **"Loyola - Gymnasium"** në Prizren dhe ka konstatuar se ky institucion i plotëson kushtet e dhe kriteret e përcaktuara ligjore për licencimin e drejtimeve të përfshira në pikën 1 të këtij vendimi për arsye se ai:

*ka ofruar këto kushte dhe kritere:*

- ka infrastrukturë shkollore të mjaftueshme dhe të përshtatshme,
- ka kuadër mësimdhënës të kualifikuar,
- ka plan programe të pranuara nga MASHT,
- ka plan të specifikuar të biznesit,
- ka aktet e nevojshme nënligjore dhe

**Udhëzime juridike**: kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në komisionin për ankesa në MASHT.

**Vendimi u dorëzohet:**

- IAP "Loyola " në Prizren,
- Kabinetit të Ministrit / MASHT,
- Zyrës së SP / MASHT,
- Zyrës Ligjore / MASHT,
- Zyrës së Arsimit Privat / MASHT.

**Fehmi Ismaili,**
**Sekretarit Përhershëm**

UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

| MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË | MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY | MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU |
|---|---|---|
| Zyra e Sekretarit të Përhershëm | Office of the Permanent Sekretara | Kancelarija Stalnog Sekretara |

Nr. 710 / 02-1
Dt: 19.12.2005
Prishtinë

Në bazë të nenit 5.4 pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), nenit 41 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2003, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ( MASHT) merr këtë :

## V E N D I M

1. Institucionit Arsimor Privat (IAP) "**Loyola**" në Prizren i jepet licenca për ushtrimin e veprimtarisë edukativo–arsimore për vitin shkollor 2005/06.

2. IAP "Loyola " në Prizren do të ushtrojë veprimtarinë e vet arsimore në nivelet 2 dhe 3 (sipas ISCED) për këto klasa dhe drejtime:

   a) **niveli 2 :** klasa VI – 4 paralele, gjithsej 89 nxënës dhe
   klasa VII – 5 paralele, gjithsej 95 nxënës;

   b) **niveli 3**: klasa X - drejtimi gjimnaz i përgjithshëm, një (1) paralele, deri në 32 nxënës

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

MASHT, në bazë të rekomandimit komisionit përkatës, merr Vendim që IAP "**Loyola**" në Prizren t`ia jep licencën pasi ka konstatuar se i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara ligjore, për nivelet e përfshira në pikën 2 të këtij vendimi, për arsye se ai:

- ka kërkesën me dokumentacionin e kompletuar,
- ka infrastrukturë shkollore të mjaftueshme,
- ka kuadër mësimdhënës të kualifikuar,
- ka planprograme të pranuara nga MASHT,
- ka garancion financiar,
- ka plan të specifikuar të biznesit,
- ka aktet e nevojshme nënligjore,

prandaj u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzime juridike:** kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, në gjykatën kompetente.

**Vendimi u dorëzohet:**

- IAP "Loyola " në Prizren,
- Kabinetit të Ministrit / MASHT,
- Zyrës së SP / MASHT,
- Zyrës Ligjore / MASHT,
- Zyrës së Arsimit Privat / MASHT.

Fehmi Ismaili,
UD i sekretarit të përhershëm